



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 qershor 2013
Nr. ref.: RK426/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI110/12

Parashtrues

Dara Menkovič

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit për shpalljen e listës
përfundimtare të 20%-shit, të hartuar nga Agjencia Kosovare e
Privatizimit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga znj. Dara Menkovič, me vendbanim në Cernicë, fshat në komunën e Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin për shpalljen e listës përfundimtare dhe mospagesën e shumës së 20%-shit nga privatizimi i ndërmarrjes së tekstilit “INTEGJ”, me seli në Gjilan, nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet se është larguar nga pagesa e shumës së 20%-shit nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore “INTEGJ”, me seli në Gjilan, përkundër dorëzimit me kohë të të gjitha dokumenteve të nevojshme për pagesën e kësaj shume.
4. Parashtruesi nuk i referohet asnjë dispozite të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 1 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
7. Më 6 nëntor 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që ta plotësojë kërkesën në pajtim me rregullin 36.4 të Rregullores së punës.
8. Më 22 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një dokument shtesë, “Aktvendim për përcaktimin e koeficientit për pagesën e rrogës”.
9. Më 4 dhjetor 2012, Kryetari me Vendimin Nr. GJR. KI110/12 caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI110/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (gjyqtare kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 14 dhjetor 2012, Gjykata njoftoi AKP-në përkitazi me regjistrimin e kërkesës.
11. Më 5 shkurt 2013, Gjykata kërkoi nga AKP-ja që, në afatin kohor 15-ditësh, AKP-ja të japë komentet për atë se pse parashtruesi i kërkesës është përjashtuar nga lista dhe pse parashtruesja e kërkesës nuk i ka marrë mjetet (20%) nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes Shoqërore “INTEGJ”, me seli në Gjilan.
12. Më 14 shkurt 2013, AKP-ja i është përgjigjur çështjeve të ngritura nga Gjykata.

13. Më 29 prill 2013, Kryetari me Vendimin Nr.KSH.KI110/12 bëri zëvendësimin e gjyqtarëve të Kolegjit shqyrtues. Në vend të gjyqtarës Arta Rama-Hajrizi anëtar të Kolegjit shqyrtues KI110/12 u caktua Kryetari Prof. Dr. Enver Hasani.

Përmbledhje e fakteve

14. Parashtruesi i kërkesës ankohet se, kundër dëshirës së saj, është larguar nga pagesa e shumës së 20%-shit nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "INTEGJ", me seli në Gjilan, përkundër dorëzimit me kohë të të gjitha dokumenteve të nevojshme për pagesën e kësaj shume.
15. Më 14 shkurt 2013, AKP-ja, në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës përkritazi me çështjet e ngritura nga Gjykata, ka theksuar se parashtruesi i kërkesës gjendet në listën përfundimtare të punëtorëve, të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hollave nga pjesa e shumës së 20%-shit nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "INTEGJ", me seli në Gjilan. AKP-ja, në përgjigjen e saj, më tej thekson se disa nga ankuesit e kanë kundërshtuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për marrjen e kësaj shume, andaj parashtruesi nuk është përjashtuar nga lista, por është kundërshtuar e drejta e saj nga ana e ankuesve, dhe AKP-ja është duke pritur vendimin meritator të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme përkritazi me kundërshtimin për të proceduar më tutje me shpërndarjen e mjeteve.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi pretendon se "AKP-ja, gjatë procedurës për ndarjen e shumës së 20%-shit nga procesi i privatizimit të ndërmarrjes "INTEGJ", me seli në Gjilan, ka bërë diskriminim me rastin e pagesës së punëtorëve që e kanë fituar të drejtën në pagesë, në pajtim me nenin 2, paragrafi 1, pika a-b, sipas nenit 3, paragrafi 1, në lidhje me nenin 4, paragrafi a, i, j, k, të Ligjit kundër diskriminimit, Nr. 2004/3, pasi punëtorët e tjerë, të cilët ishin përfshirë në listë, kishin marrë një pjesë të të hollave të 20%-shit".
17. Parashtruesi pretendon se "ajo ka qenë në këtë listë, por nuk ka marrë të holla, përkatësisht pohon se është përjashtuar nga pagesa kundër dëshirës së saj".

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Për këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkelljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.
20. AKP-ja, në shkresën e saj drejtuar Gjykatës, më 14 shkurt 2012, thekson se e drejta e parashtruesit të kërkesës për marrjen e shumës së 20%-shit nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "INTEGJ", me seli në Gjilan, është

kundërshtuar nga ana e ankuesve dhe se AKP-ja është duke pritur vendimin meritator të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, përkitazi me kundërshtimin, për të proceduar më tutje me shpërndarjen e mjeteve. Përderisa procesi është në vazhdim e sipër dhe nuk ka vendim përfundimtar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, parashtuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

21. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose për ta korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjete efektive për mbrojtjen e të drejtave të garantuara me kushtetutë (*Shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni v. France, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999*).
22. Kjo Gjykatë e ka përdorur të njëjtin arsyetim në Vendimin për papranueshmëri, më 27 janar 2010, mbi bazën e mosshterjes së mjeteve juridike në Rastin Nr. KI41/09, Universiteti AAB-RIINEST sh.p.k., Prishtinë, kundër Qeverisë së Kosovës; dhe në Vendimin e 23 marsit 2010, në Rastin Nr. KI73/09, Mimoza Kusari kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
23. Duke u bazuar në shkresën e dërguar nga AKP-ja, më 14 shkurt 2013, kuptohet se çështja e ngritur nga parashtuesi është ende në procedurë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme andaj kërkesa e parashtuesit është e parakohshme. Prandaj, parashtuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore të ofruara me ligj, siç kërkohet, në mënyrë që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.1 pika (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 qershor 2013, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani